



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Spanja gati të anojë djathtas? Sondazhi: Nëse zgjedhjet do mbaheshin sot, koalicioni Partia Popullore-Vox do të fitonte në 38 nga 50 provinca
- 2

EKSKLUZIVE/ Tritoli i shkatërron gjysmën e shtëpisë, i shumëkërkuari Ylli Zalla shfaqet para banesës: S'dua azil politik! Policia dhe bandat duan të më vrasin! (VIDEO)
- 3

Qatip Doda, agronomi që u bë fermer: Si e zbulova mjedrinë, frutin fllimprurës me kërkesë të lartë në treg! Shtet deri në 500 lek/kg
- 4

SPAK hap garën për 40 pozicione betuesish në BKH, kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët dhe afati i aplikimit
- 5

Natë tmerri, digjet hoteli në Vlorë, pushuesit hidhen nga ballkoni për të shpëtuar! 6 të plagosur, 5 dërgohen në Tiranë, një vajzë me djegie të rënda (VIDEO)

Kronikë

Në kërkim prej vitit 2025, eksploziv në shtëpinë e Ylli Zallës në Fushë-Krujë, gruaja njoftoi policinë nga Italia! Dyshohet se ngjarja mund të jetë inskenuar për azil

Shpërthimi me lëndë plasëse në banesën e Ylli Zallës në Fushë-Krujë u zbulua vetëm paraditen e së dielës, pasi policia u njoftua nga gruaja e tij, e cila ndodhej në Itali. Nga shpërthimi u dogj edhe automjeti i 49-vjeçarit, ndërsa hetuesit po verifikojnë edhe pistën që lënda plasëse mund të jetë vendosur nga vetë Zalla.

■ Tritoli i shkatërron gjysmën e shtëpisë, i shumëkërkuari Ylli Zalla shfaqet para banesës: S'dua azil politik!

■ 'Benzi' i Ylli Zallës bëhet shkrumb e hi, Report TV siguron fotot e para nga shtëpia e 49-vjeçarit pas shpërthimit

Në kërkim prej 2025-ës, eksploziv në shtëpinë e Ylli Zallës, shfaqet për Report TV



Watch on

Sokol Dema 16 Gusht, 10:45 | Përditësimi: 16 Gusht, 19:37

Share Post WhatsApp


Një shpërthim me tritol është regjistruar gjatë natës në fshatin Zall, Fushë-Krujë në derën e banesës së të Ylli Zallës, një emër i njohur për policinë, i dyshuar si bashkëpunëtor në atentatin e Rinasit dhe i shpallur në kërkim pas zbulimit të arsenalit të armëve më 20 shkurt të këtij viti.

Nga shpërthimi janë shkatërruar dëme materiale, ndërsa flakët kanë përfshirë edhe automjetin e Zallës, i cili ishte i parkuar pranë banesës dhe është djegur plotësisht.

"Gjatë natës, në fshatin Zallë, Fushë-Krujë, në derën e banesës së shtetasit Y. Z., dyshohet se është vendosur dhe ka shpërthyer një sasi e dyshuar lëndë plasëse. Si pasojë, janë shkatërruar dëme materiale, si dhe ka marrë flakë dhe është djegur automjeti në pronësi të këtij shtetasi, i cili ishte i parkuar pranë banesës. Grupi hetimor po vijon punën për identifikimin dhe kapjen e autorit, si dhe për dokumentimin e plotë të rrethanave të rastit" thuhet në njoftimin e policisë.

[Sh]

LEXO EDHË:
EKSKLUZIVE/ Tritoli i shkatërron gjysmën e shtëpisë, i shumëkërkuari Ylli Zalla shfaqet para banesës: S'dua azil politik! Policia dhe bandat duan të më vrasin! (VIDEO)



Dyshohet se ngjarja mund të jetë inskenuar për azil jashtë shtetit

Shpërthimi me lëndë plasëse dyshohet se ka ndodhur vonë në mbrëmjen e së shtunës, ndërsa policia është njoftuar vetëm paraditen e sotme nga gruaja e Ylli Zallës, e cila ndodhej në Itali.

Sipas burimeve, fillimisht gruaja e Ylli Zallës ka pretenduar se, përveç lëndës plasëse, pranë banesës ishte gjetur edhe një letër kërcënuese.

Më pas, ajo e ka tërhequr këtë pretendim, i cili po verifikohet nga hetuesit. Besohet se letra është hequr pasi përmes ekspertizës grafoteknike të shkrimit, mund të analizohet dhe kuptohet kush e ka shkruar.

Sipas burimeve, një nga pistat që po verifikohet nga hetuesit është edhe mundësia që lënda plasëse të jetë vendosur nga vetë Zalla, megjithatë rrethanat e ngjarjes mbeten ende nën hetim. Në vendngjarje nuk ka kamera sigurie, çka do ta vështirësojë zbardhjen e plotë të rastit, pasi shpërthimi nuk është filmuar.

Hetuesit nuk përjashtojnë mundësinë që Zalla të jetë larguar nga vendi ilegalisht dhe të ketë inskenuar ngjarjen për të kërkuar azil jashtë me pretendimin se i rrezikohet jeta.

Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për identifikimin e autorit, si edhe për zbardhjen e plotë të rrethanave.

Kush është Ylli Zalla

Ylli Zalla rezulton në kërkim që prej nëntorit 2025, kur në banesën e tij u zbulua arsenal armësh, pas hetimeve lidhur me atentatin në Rinas. Zalla dyshohet si bashkëpunëtor në atentatin e nëntorit 2025 ku u vranë Gilmando Dani dhe Muçi Shaljani, akuzu të cilat nuk u zbardhën asnjëherë.

Më 20 shkurt të këtij viti, policia zbuloi një tjetër arsenal armësh në fshatin Zall që dyshohet se i përkisnin 49-vjeçarit

Ndërkohë 12 vjet më parë, Ylli Zalla është arrestuar për prodhim të bombave artizanale dhe i përfshirë edhe në prodhim dhe shitje droge. Në atë kohë dyshohej për lidhje me grupin ISIS për rekrutime të shqiptarëve për xhihad. Vite më parë ai kishte kërcënuar me jetë edhe pronarin e një kompanie çimentoje në Fushë Krujë.

Lajmi në përditësim...

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Rendit zhvillimet sipas orarit: Te Fundit

Ora 19:29

EKSKLUZIVE/ Tritoli i shkatërron gjysmën e shtëpisë, i shumëkërkuari Ylli Zalla shfaqet para banesës: S'dua azil politik! Policia dhe bandat duan të më vrasin! (VIDEO)

REPORT TV

EKSKLUZIVE/ Tritoli i shkatërron gjysmën e shti

Report TV



Watch on

Report Tv ka siguruar pamje nga pasojat e shkaktuara nga shpërthimi me tritol gjatë natës në banesën e Ylli Zallës në fshatin Zall në Fushë-Krujë.

Nga pamjet duket se sasia e lëndës plasëse ka qenë e konsiderueshme, pasi rreth gjysma e banesës ka dalë jashtë përdorimit.

Ndërkohë pranë banesës është shfaqur edhe vetë Ylli Zalla, i cili ndodhet në kërkim për atentatin në Rinas.

Përmes një videoje, Zalla mohon se tritolin e ka vendosur vetë për të marrë azil politik, teksa akuzon Policinë dhe bandat e krimit të organizuar se po përpiqen ta vrasin.

"Unë Ylli Zalla në nëntor 2025 vjen Policia e Shtetit më akuzon për lidhjen e Rinasit. Hyjnë makina, dalin makina. Pa ekspertizë e pa asnjë lloj prove më ngatërrojnë me bandat. Kalojnë disa muaj dhe gjejnë armatim, Ylli Zalla s'ka armatim. Pas kësaj, në qershor 2026, në datën 22 më vijnë Policia e Shtetit pas shtëpie me më vra vdek e në tokë. Unë jam hallexhi, kam fëmijët pa bukë. Ja çfarë më ka bërë mua Policia e Shtetit. Unë dyshoj te Policia dhe bandat. Gazetarët flasin kot, thonë kërkon azil. Unë nuk kërkoj azil, nuk largohem nga prona ime", thotë mes të tjerash Zalla.

Ylli Zalla është shpallur në kërkim që prej nëntorit 2025, pasi është i dyshuar si bashkëpunëtor në atentatin e Rinasit. Më pas, në 20 shkurt të këtij viti, atij iu gjet edhe një arsenal armësh, me të cilat dyshohet se furnizonte grupet kriminale.

R.Xh/Shqiptarja.com

Share WhatsApp

Ora 12:21

'Benzi' i Ylli Zallës bëhet shkrumb e hi, Report TV siguron fotot e para nga shtëpia e 49-vjeçarit pas shpërthimit

Report TV ka siguruar pamje nga banesa dhe automjeti i Ylli Zallës pas shpërthimit me lëndë plasëse në fshatin Zall, Fushë-Krujë. Në foto duket se automjeti tip "Benz" është shkrumbuar plotësisht, ndërsa rezultton të ketë pësuar edhe dëmin më të madh nga shpërthimi.



Pamjet nga banesa tregojnë xhama të thyer, tjegulla të rrëzuara dhe dëme të shumta materiale.



U.D/Shqiptarja.com

Share WhatsApp

U.D/R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: ylli zalla krujë zallë shperthim me tritol fushe kruje

Sa e vlerësoni këtë artikull? 4.0 / 5 (4 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohejt repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Cili është shkaku i konflikteve në Shqipëri?

15 Gusht, 13:45

Politika Shqetëria Social media

Lajme të tjera



'Benzi' i Ylli Zallës bëhet shkrumb e hi, Report TV siguron fotot e para nga shtëpia e 49-vjeçarit pas shpërthimit

16 Gusht, 12:21



Nga Dajti në Gurë-Lurë të Dibrës, 8 vatra aktive zjarri në vend! Ministria e Mbrojtjes: S'ka rrezik për zonat e banuara! Nga ajri është operuar me 3 helikopterë dhe 2 avionë

16 Gusht, 10:22



Kruja ende në flakë, banorët djejin mbeturina

15 Gusht, 10:38




Krujë/ Zidolli i mbuluar nga tymi, zjarrfikësit në garë me kohën për të shuar flakët

14 Gusht, 18:24



Zjarret/ Lura në flakë, digjen 300 hektarë pyje! Riaktivizohet vatra në Zidoll të Krujës, zjarrfikësit në terren për normalizimin e situatës

14 Gusht, 09:04




Muzeu Kombëtar 'Gjergj Kastrioti Skënderbeu' në Krujë, destinacioni historik që tërheq turistët e huaji (VIDEO)

14 Gusht, 08:09




Shpërthim i fortë në portin e Roterdamit, 1 i vdekur e disa të plagosur, pezullohet puna në disa kompani

13 Gusht, 16:40




Kruja s'gjen qetësi, flakët 400 metra nga banesat në Abaze! Zjarrfikësit 'heronj', të sflutur e me ilaçe nuk heqin dorë: Këtu derisa të shuhet vatra e fundit

13 Gusht, 13:37



'Largohu!' Pas zjarrit, rrezik i ri në Abaze të Krujës, gurët shkëputen nga mali (VIDEO)

13 Gusht, 08:23



Zjarret/ Situatë problematike në Parkun e Lurës në Dibër, në operacion rreth 220 forca! Vihen nën kontroll zjarret në Lundër e Priskë, pamje me dron (VIDEO)

13 Gusht, 07:04



Era e fortë përhap zjarrin drejt banesave në Krujë, banorët largojnë fëmijët dhe të moshuarit, presin pemët për t'i penguar flakët (VIDEO)

12 Gusht, 20:15



Era e fortë favorizon zjarret në Krujë, tre vatra aktive! Ndërhijë me mjete dhe njerëz nga toka (VIDEO)

12 Gusht, 19:43

Lajmi i fundit



Spanja gati të anojë djathtas? Sondazhi: Nëse zgjedhjet do mbaheshin sot, koalicioni Partia Popullore-Vox do të fitonte në 38 nga 50 provinca

16 Gusht, 20:55

nga Alessandra Muglia

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh


Raportoni Ju

Pu





✕ **[Sh]**
.com Lajmi i fundit



**Spanja gati të anojë djathtas?
Sondazhi: Nëse zgjedhjet do
mbaheshin sot, koalicioni Partia
Popullore-Vox do të fitonte në 38
nga 50 provinca**

16 Gusht, 20:55

[nga Alessandra Muglia](#)

RAPORTOI Chat live
me Shqiptarja.com

